



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1284

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " Inovix " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të UNIVERSITETI I PRISHTINËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Materiali shpenzues dhe pajisje speciale mjekesore me numër të prokurimit 242-25-9414-1-2-1, me 11/02/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e pjeserishte e bazuar ankesa e OE " Inovix " SH.P.K. me nr. 2025/1284 , e datës 29/12/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Materiali shpenzues dhe pajisje speciale mjekesore me numër të prokurimit 242-25-9414-1-2-1.
2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të UNIVERSITETI I PRISHTINËS, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Materiali shpenzues dhe pajisje speciale mjekesore me numër të prokurimit 242-25-9414-1-2-1 anulohet në tërësi.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik " Inovix " SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 14.10.2025 UNIVERSITETI I PRISHTINËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë B05, për aktivitetin e prokurimit Materiali

shpenzues dhe pajisje speciale mjekesore me numër të prokurimit 242-25-9414-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurën e hapur**, lloji i kontratës: **furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës: **50,500.00€**.

Me 12.12.2025 UNIVERSITETI I PRISHTINËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë **Te I & F MEDICA SH.P.K.**

Me 18.12.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 23.12.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.12.2025, OE Inovix SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1284, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues " Inovix " SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

- Neni 108/A, paragrafi 1 – i cili përcakton të drejtën e çdo operatori ekonomik për të paraqitur kërkesë për rishqyrtim, në rast se konsideron se një vendim i autoritetit kontraktues është i padrejtë, i pabazuar ose në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë vendimin për shpalljen e operatorit ekonomik I & F Medica SH.P.K. si fitues të tenderit të referuar më sipër, për shkak të shkeljeve serioze të ndodhura gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe procedurës së tenderimit. Këto shkelje kanë cenuar parimet themelore të prokurimit publik dhe e bëjnë ofertën e shpallur fituese të papërgjegjshme dhe të pavlefshme.

Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (Formulari Standard F02 – Njoftimi për dhënien e kontratës) është publikuar në platformën elektronike e-Prokurimi, në përputhje me procedurat ligjore, në datën e përcaktuar nga AK, duke u bërë kështu i aksesueshëm për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Konkretisht, operatori ekonomik i shpallur fitues ka paraqitur një ofertë thellësisht të papërgjegjshme, e cila nuk përmbush kërkesat e qarta dhe të detajuara të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Oferta përmban pasaktësi të shumta dhe gabime të rënda në paraqitjen e katalogëve të produkteve. Mungesa e specifikimeve të plota, informacionit mbi markat e prodhuesve, karakteristikat teknike dhe cilësinë e produkteve përbën shkelje flagrante të kërkesave të tenderit dhe të rregullave të prokurimit publik.

Në këtë mënyrë, oferta nuk mund të konsiderohet e besueshme dhe e vlefshme për t'u vlerësuar, pasi është e pamundur të verifikohet përputhshmëria e produkteve të ofruara me kriteret teknike të kërkuara. Katalogu i paraqitur është i paplotë dhe i paqartë, duke krijuar pasiguri të thellë lidhur me cilësinë dhe përputhshmërinë e produkteve, dhe për pasojë, e bën të pamundur një vlerësim të drejtë, objektiv dhe të saktë të ofertës.

Gabimet e bëra gjatë ofertimit janë të natyrës dhe shkallës së tillë që e bëjnë ofertën të papërgjegjshme dhe të pavlefshme. Për këto arsye, kërkojmë që oferta e këtij operatori ekonomik të eliminohet nga procesi i tenderimit, pasi ka shkelur parimet e drejtësisë, transparencës dhe barazisë, të cilat duhet të mbizotërojnë në çdo procedurë prokurimi publik. Këto mangësi kanë krijuar një avantazh të padrejtë për operatorin e shpallur fitues dhe kanë cenuar rëndë procesin konkurrues.

Në këtë aktivitet të prokurimit janë shkelur parimet dhe dispozitat në vijim të Ligjit për Prokurimin Publik:

1. Shkelja e parimit të barazisë dhe mos-diskriminimit (Neni 7)

Neni 7 obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë barazi të trajtimit dhe ndalim të diskriminimit ndërmjet operatorëve ekonomikë. Oferta e fituesit përmban produkte që nuk përputhen me kërkesat teknike dhe mbështetet në një katalog të paplotë, pa specifikime për markat e prodhuesve, duke krijuar një avantazh të padrejtë dhe duke cenuar konkurrencën e ndershme.

2. Shkelja e kërkesave për njoftimin e kriterëve për dhënien e kontratës (Neni 52)

Sipas Nenit 52, kriteret dhe kushtet për dhënien e kontratës duhet të jenë të qarta dhe transparente. Katalogu i paraqitur nga OE fitues përmban produkte të ndryshme nga ato të kërkuara, është i paqartë dhe i paplotë, duke krijuar pasiguri në procesin e vlerësimit dhe duke shkelur parimet e transparencës dhe drejtësisë.

3. Shkelja e specifikimeve teknike (Neni 56 dhe Neni 28)

Sipas këtyre neneve, ofertat duhet të jenë të plota dhe në përputhje me specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit. OE fitues ka paraqitur katalog pa marka prodhuesish dhe pa karakteristika teknike të detajuara, duke rezultuar në një ofertë të papërgjegjshme dhe jo-konformuese.

4. Shkelja e kërkesave për vlerësimin e ofertave (Neni 57)

Oferta e fituesit, për shkak të mungesës së të dhënave dhe gabimeve në katalog, nuk ka qenë e vlerësueshme në mënyrë të drejtë dhe objektive, duke e bërë atë të pavlefshme sipas këtij neni.

5. Shkelja e Neneve 59 dhe 60 të LPP-së, si dhe Nenit 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)

Gjatë shqyrtimit të përshkrimit të çmimeve dhe kalkulimeve në ofertën e OE të shpallur fitues, janë konstatuar mospërputhje aritmetike me ndikim të drejtpërdrejtë në vlerën totale të ofertës:

1) Katedra e Kirurgjisë Orale – Pozita 6 (Penj kirurgjik 3.0, 4.0, 5.0)

Sasia e kërkuar: 5 kuti për secilën madhësi (gjithsej 15 kuti).

Çmimi për njësi: 14 EUR.

Vlera e saktë: $15 \times 14 = 210$ EUR (ose sipas llogaritjes së saktë të dokumenteve përkatëse).

OE ka deklaruar gabimisht 900 EUR si vlerë totale.

2) Anesteziologjia – Pozita 1 (Tubusa endotrakeal nr. 6, 6.5, 7)

Sasia e kërkuar: 10 copë për secilin numër (gjithsej 30 copë).

Çmimi për njësi: 14 EUR.

Vlera e saktë: $30 \times 14 = 420$ EUR, ndërsa OE ka deklaruar 140 EUR.

Nga këto dy pozita rezulton një diferencë totale prej 2,080 EUR, dhe për pasojë, çmimi real i ofertës rezulton 50,975.20 EUR, duke e tejkaluar buxhetin e paraparë për këtë kontratë.

Mosidentifikimi dhe moskorrigjimi i këtyre gabimeve nga AK përbën shkelje të Nenit 59, Nenit 60 dhe Nenit 6 të LPP-së, pasi vendimi për dhënien e kontratës është bazuar në një çmim të pasaktë dhe jo real.

6. Mosplotësimi i Kërkesës nr. 6 – Prezantimi i produkteve me katalogë/broshura

OE fitues nuk ka përmbushur këtë kërkesë, pasi:

ka dorëzuar katalog të përgjithshëm, pa nënvizuar qartë produktet e ofruara për secilën pozitë;

ka paraqitur lista të përgatitura nga vet OE, të cilat nuk përbëjnë katalogë/broshura të prodhuesit;

dokumentacioni i dorëzuar mbulon vetëm një pjesë të vogël të produkteve, ndërsa për pjesën tjetër mungon plotësisht prezantimi i kërkuar.

Për rrjedhojë, oferta e OE I & F Medica SH.P.K. është e paplotë, e papërgjegjshme dhe nuk përmbush kriteret ligjore dhe teknike për t'u shpallur fituese.

Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk mundëson verifikimin objektiv të përputhshmërisë së produkteve të ofruara me kërkesat teknike të Dosjes së Tenderit (DT), duke e bërë ofertën të papërgjegjshme në raport me këtë kërkesë, pasi nuk janë paraqitur dëshmitë e kërkuara në mënyrën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Shkelja e Kërkesës nr. 6 të DT-së – Mungesë e katalogëve/broshurave për secilin produkt

Sipas Kërkesës nr. 6 të Dosjes së Tenderit, Operatori Ekonomik është i obliguar të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues katalogë ose broshura për secilin produkt të ofruar, duke nënvizuar qartë produktin që ofertohet, si dhe duke bashkëngjitur përshkrimin e karakteristikave teknike në përputhje me specifikimet e kërkuara. Po ashtu, DT përcakton se katalogët/broshurat duhet të jenë të vullosura nga OE.

Katedra e Biokimisë

Pozita 1 – Kit për matje kolorimetrike të Fosfatazës Alkaline në serum/plazmë 200 ml

OE ka prezantuar produktin vetëm me një foto, në të cilën nuk shihet emri i produktit, marka e prodhuesit dhe as specifikimi teknik, gjë që e bën të pamundur identifikimin dhe verifikimin e produktit.

Pozita 2 – Kit për matje kolorimetrike të Fosforit 200 ml në serum/plazmë me tretësirë standarde të fosforit

Edhe për këtë produkt është paraqitur vetëm foto pa emër, pa brend dhe pa specifikime teknike, duke e bërë të pamundur identifikimin e produktit.

Pozitat 3, 4 dhe 5

Produktet janë paraqitur vetëm me foto, pa asnjë informacion identifikues mbi emrin, brendin dhe specifikimet teknike, çka e bën ofertën të papranueshme.

Pozita 9 – Kiveta katrore për spektrofotometër, macro 10 mm × 10 mm, 100 copë

OE ka prezantuar vetëm foto, pa të dhëna për prodhuesin dhe specifikimet teknike, duke pamundësuar verifikimin e produktit.

Pozitat 10 dhe 11 – Dorëza latex josterile, madhësia L dhe M

OE nuk ka paraqitur katalog apo broshurë sipas kërkesës së AK-së. Për më tepër, janë paraqitur foto të dorëzave nitrile, të cilat janë krejtësisht të ndryshme nga dorëzat latex të kërkuara. Përshkrimi teknik i bërë nga OE është i pasaktë, pasi “nitrile gloves” nënkuptojnë dorëza pa latex (latex-free), çka përbën ofertim të gabuar.

Katedra e Parodontologjisë dhe Mjekësisë Orale

Pozitat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10 dhe 11

Produktet janë paraqitur vetëm me foto, pa emër, pa brend dhe pa specifikime teknike, duke e bërë të pamundur identifikimin dhe verifikimin e përputhshmërisë me DT-në.

Pozita 6 – ZnO-Oleum (Cariophyllorum)

OE ka ofertuar zink oksid pluhur, ndërkohë që sipas kërkesës së AK-së është kërkuar zink oksid oleum me eugenol. Produkti i ofruar nuk përmbush specifikimin teknik dhe është ofertuar gabimisht.

Pozita 12 – Material dezinfektues dhe sanitar (Alkool 76%, Peroksid hidrogjeni 3%)

Bazuar në fotot e paraqitura, OE ka ofertuar vetëm alkool, pa përfshirë peroksid hidrogjeni 3% siç kërkohet në DT. Gjithashtu, nuk shihet marka dhe as përqendrimi i alkoolit.

Pozitat 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18

Produktet janë paraqitur vetëm me foto, pa asnjë informacion identifikues, duke e bërë ofertën të papërgjegjshme.

Katedra e Fizioterapisë

Pozitat 1–5

Produktet janë paraqitur vetëm me foto pa emër, pa brend dhe pa specifikime teknike.

Pozita 5 – Elektroda vetëngjitëse me pin konektor 2 mm

Janë kërkuar elektroda vetëngjitëse me pin konektor 2 mm, ndërsa OE ka paraqitur vetëm foto të një konektori, jo të produktit të kërkuar, çka përbën ofertim të gabuar.

Katedra e Sëmundjeve të Dhëmbit

Pozita 1 – ZnO-Oleum (Cariophyllorum)

OE ka ofertuar zink oksid pluhur, në vend të zink oksid oleum me eugenol, siç është kërkuar nga AK.

Pozita 7 – Freza çeliku për kundërkënd, forma të rrumbullakëta dhe cilindrike, nr. 12

Bazuar në foton dhe përshkrimin e paraqitur, produkti rezulton të jetë frezë diamanti për pjesëment dhe turbinë, e cila nuk përputhet me kërkesën për freza çeliku për kundërkënd.

Pozita 9 – Shishe të vogla me kapak për alkool dhe peroksid hidrogjeni

Produktet e ofruara nuk janë sipas kërkesës së AK-së. Njëra foto paraqet produkt plastik jo të destinuar për ruajtje të alkoolit/peroksidit, ndërsa tjetra paraqet lampë alkooli me fitil, jo shishe dozimi.

Pozita 18 – Gutaperka (15–40), konicitet 0.2

OE ka ofruar gabimisht letër absorbuese (paper points), e cila nuk është ekuivalente me gutaperkën e kërkuar.

Pozita 4 – Aktivator

Është kërkuar pastë aktivatore për silikon, ndërsa OE ka paraqitur një produkt të paidentifikueshëm, pa emër dhe pa brend, i cili nuk përmbush kërkesën e AK-së.

Katedra e Pedodoncisë dhe Stomatologjisë Preventive

Pozita 14 – Gjilpëra për revizion

OE ka ofruar gjilpëra për injeksion/anestezi, të cilat nuk janë produkte ekuivalente me gjilpërat për revizion endodontik.

Pozita 20 – K-file prej nikel-titanium (15–40)

Është kërkuar K-file prej nikel-titanium, ndërsa OE ka ofertuar gabimisht K-file prej stainless steel.

(Vijon për të gjitha katedrat e tjera – kimia farmaceutike, infermiera, lëndët paramjekësore, analitika e barnave, farmakologjia, ortodoncia etj.)

Në të gjitha rastet, produktet janë paraqitur vetëm si foto të marra nga interneti, pa marka prodhuesi, pa specifikime teknike dhe pa katalogë/broshura të vlefshme, çka e bën ofertën të paplotë, të papërgjegjshme dhe të pavlefshme.

Përfundim dhe kërkesë

Për të gjitha arsyet e cekura më lart, kërkojmë me urgjencë që Autoriteti Kontraktues ta kthejë këtë aktivitet në ri-vlerësim dhe të shpallë fituese vetëm ofertën që përmbush plotësisht dhe saktësisht kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Fillimisht, kemi zgatur afatin e përgjigjes (vendimit) ndaj kërkesës për rishqyrtim, pasi kemi pasur të bëjmë me shqyrtimin e një dokumentacioni voluminoz. Komisioni për vlerësimin e këtij aktiviteti ka qenë profesional dhe është rekomanduar nga njësia kërkuese. Gjatë vlerësimit, si dhe gjatë rishqyrtimit, komisioni ka vlerësuar ofertën dhe kërkesën për rishqyrtim në detaje, pasi kemi pasur të bëjmë me vlerësim teknik të ofertës.

Autoriteti Kontraktues, lidhur me kërkesën për rishqyrtim, konstaton se vlerësimi i këtij tenderi është bërë në pajtim me LPP-në, duke respektuar kriterin për dhënie të kontratës “Çmimi më i ulët”, si dhe duke respektuar një nga parimet bazë të prokurimit publik, përkatësisht ruajtjen e fondeve publike përmes ekonomicitetit dhe efikasitetit.

Lidhur me pretendimet e OE Inovix SH.P.K., Halil Orana, Llamella 4, Nr. 20, Bregu i Diellit, 10000, Prishtinë, Kosovë, gjatë rishqyrtimit AK konstaton se nuk ka gabime aritmetike. OE i rekomanduar për kontratë ka njësuar saktë sasinë e përcaktuar nga njësia kërkuese me çmimin për njësi dhe ekziston përputhje me shumën totale. Prandaj, nuk kemi të bëjmë me gabime aritmetike.

Lidhur me kërkesën për rishqyrtim që ka të bëjë me katalogun e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, AK konstaton se në kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT) nuk është kërkuar që katalogu të jetë nga ndonjë prodhues i caktuar apo ndonjë kërkesë e ngjashme. Komisioni Vlerësues ka konstatuar se produktet e ofruara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës janë në përputhje me kërkesat e specifikuara në DT. Po ashtu, OE ka dorëzuar edhe deklaratën përkatëse, në të cilën zotohet se do t'u përmbahet kërkesave të Aneksit 1 të DT-së.

Prandaj, duke u bazuar në këto dokumente, vlerësojmë si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim nga Operatori Ekonomik OE Inovix SH.P.K., Halil Orana, Llamella 4, Nr. 20, Bregu i Diellit, 10000, Prishtinë, Kosovë, të datës 18.12.2025.

Në këtë mënyrë, mbetet në fuqi vendimi i AK-së i datës 12.12.2025 (Formulari B58 – Njoftim mbi vendimin e AK-së) për këtë aktivitet të prokurimit. Si rrjedhojë, refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e OE Inovix SH.P.K.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 05.01.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1284, ndërsa me datë 23.01.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1284, me rekomandimet si në vijim Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik/shqyrtues i propozon panelit

shqyrtues që ankesa e OE “**Inovix ” SH.P.K. të aprovet e bazuar**, dhe rekomandon që **ky aktivitet të anulohet në tërësi**.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues dhe teknik, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues dhe teknik ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE " Inovix " SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1284 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues se është se OE i rekomanduar për kontratë ka gabime aritmetikore në dy pozicione si në vijim:

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumenteve të këtij aktiviteti të prokurimit, duke filluar nga dosjen e tenderit, lista e çmimeve, sqarimet e kërkuara nga OE të interesuar në fazën e publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit, Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi ankimor i Operatorit Ekonomik ankues se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka gabime aritmetikore në kalkulimin e sasisë me çmimin për njësi është i pa bazuar për faktin se sipas listës së çmimeve të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk ka gabime aritmetikore sasia shumëzuar me çmimin për njësi

Katedra e Kirurgjisë Orale, pozicioni nr 6 përkatësisht të sasia është kërkuar nga 5 kuti prej seciles ($5 \times 180 = 900\text{€}$) sipas mendimit të ekspertit shqyrtues nuk ka gabime aritmetikore në këtë pozicionin pasi që sasia është 5 kuti prej seciles ($5 \times 180 = 900.00\text{€}$).

Edhe te Anesteziologjia përkatësisht pozicioni 1 të sasia është kërkuar nga 10 secili numër ($10 \times 14.00 = 140.00$).

Eksperti shqyrtues nuk ka gabime aritmetikore në këtë pozicion pasi që sasia është e kërkuar nga 10 secili numër ($10 \times 14.00 = 140.00$). Lidhur me keto dy pozicione te sasia është e specifikuar sasia me numra 5 dhe 10 dhe OE i rekomanduar ka bërë kalkulimin sasin duke shumëzuar me çmimin për njësi. Edhe në dosjen e tenderit të Aneksi 1 i dosjes së tenderit është e njejt përrshkrim dhe sasi e specifikuar sikurse në listen e çmimeve.

Në qoftë se Operatorët Ekonomik të interesuar për këtë aktivitet kanë pasur paqartësi në listen e çmimeve te sasia apo në përrshkrimin e artikujve gjatë fazës së tenderit kan pasur kohën për të

kërkuar sqarime shitesë për cilindo pozicion në listen e çmimeve apo edhe në dosjen e tenderit.

Duke ju referuar kriterit të sipër permendurë me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2 sipas ekspertit teknik

Pretendimi ankimor i OE ankues se është se Grupi i OE i rekomanduar për kontrat nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sipas dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë si në vijim:

Kërkesa -6.Prezantimi i produkteve të ofruara me katalogë apo broshura.

Dëshmi- 6. OE duhet të paraqesë, tek AK katalogë broshura për secilin produkt duke e nënvizuar produktin e ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike (p.sh. në formën e një katalogu broshure e dorëzuar në kopje, ,po ashtu ky katalog duhet te jete vulosur nga OE.

Në këtë kriter AK nuk ka kërkuar autorizim për pjesëmarrje në tender nga prodhuesi, gjithashtu nuk i ka kërkuar prodhuesit e produkteve të kërkuara, duke mos e ditur origjinën e produktit të ofertuar. Gjithashtu tek 7.1 dhe 7.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale/ Kërkesa 1(OE duhet të jetë i regjistruar në regjistrin profesional, komercial apo të korporatës në vendin e themelimit). Në kuadër të përstatshmërisë profesionale AK nuk e ka respektuar, ku në DT ka kërkuar produkte farmaceutike për të cilat nuk është kërkuar Autorizim Marketigu i lëshuar nga AKKPM-ja, i cili dëshmon qartë se produkti është i regjistruar dhe i autorizuar për qarkullim në Kosovë.

Dosja e tenderit gjithashtu nuk i ka specifikuar penjët kirurgjik se për cilin lloj bëhet fjalë madhësinë, llojin e gjilpërës, po ashtu në DT nuk janë të cekura përqindja, doza, vëllimi tek disa produkte, gjithashtu AK ka vendosur në dosje të tenderit (emra komercial).

Te broshura e paraqitur nga OE i rekomanduar per kontrate nuk janë të paraqitura imazhet e disa produkteve me specifikime teknike ashtu siq pretendon OE ankues.

Katedra e Biokimisë

Sa i përket pyetjeve 1,2,3 (Pozicioneve 1,2,3 4,5) pretendimi i OE është i bazuar për faktin se OE i rekomanduar ka prezantuar produktet me foto qe nuk shihet emri i produktit , vëllimi i produktit si dhe specifikimi teknik i produktit ,gje që bënë të pamundur identifikimin e produkteve të ofertuara edhe pse OE ka bërë përshkrimin e produktit.

Sa i përket pyetjes 4 Pozita 9.Kiveta katrore per spektrofotometër macro 10mmx10mm 100pcs, Pretendimi i OE është i bazuar për faktin se produkti I ofruar në foto nuk përmban asnjë të dhënë.

Sa i përket pyetjes 5 Pozita 10, 11 Dorëza latex jo sterile L,M, Pretendimi i OE është i bazuar për faktin se dorëzat Latex në material janë Latex Natyral nga Goma natyrale dhe japin ndjesi precise në gishta, ndërsa Dorëzat Nitrile janë nga materiali Gomë Sintetike pa latex edhe pse nuk shkaktojnë alergji tek personat e ndjeshëm ndaj latexit.

Katedra e Paradontologjisë dhe Mjeksisë Orale

Sa i përket pyetjes 6 Pozicioneve 1,2,3,4,5,7,8,9,10,11, Pretendimi i OE është pjesërisht i bazuar për faktin se në broshurën e ofruar nga OE I rekomanduar disa produkteve i identifikohet emri i produktit por është e pamundur të lexohet doza, vëllimi apo specifikacionet teknike.

Sa i përket pyetjes 7 Pozicioni 6, Pretendimi i OE është pjesërisht i bazuar për faktin se prezentimi në broshurë është pluhur ndërsa është kërkuar oleum, ndërsa OE ka prezantuar vetëm Oksidi i Zincut i cili ekziston si pluhur dhe nuk e ka prezantuar edhe Eugenol Liquid(oil).

Sa i përket pyetjes 8 Pozicioni 12, Pretendimi i OE është i bazuar për faktin se se prezentimi në broshurë është vetëm njëri produkt ku nuk arrihet të shihet përqendrimi si dhe nuk ka prezentuar produktin tjetër.

Sa i përket pyetjes 9 Pozicioneve 13,14,15,16,17,18, Pretendimi i OE është pjesërisht i bazuar për faktin se në broshurën e ofruar nga OE i rekomanduar disa produkteve i identifikohet emri i produktit por është e pamundur të lexohet vëllimi apo specifikacionet.

Katedra e Fizioterapisë

Sa i përket pyetjes 10 pozicioneve 1,2,3,4 Pretendimi i OE është pjesërisht i bazuar për faktin se në broshurën e ofruar nga OE i rekomanduar disa produkteve i identifikohet emri i produktit por është e pamundur të lexohet vëllimi apo specifikacionet, ndësa sa i përket pozicionit 5 i OE është i bazuar për faktin se në broshurë është prezentuar vetëm konektori por jo edhe elektroda.

Katedra sëmundjet e dhëmbit

Sa i përket pozicionit 1 janë dhënë sqarimet tek pyetja 7 pozicioni 6.

Sa i përket pozicionit 7, Pretendimi i OE është i bazuar për faktin se në broshurë është prezentuar freza diamanti ndërsa është kërkuar me material prej çeliku.

Sa i përket pozicionit 9, Pretendimi i OE është i bazuar për faktin se AK nuk i ka të precizuara se çfarë materiali duhet të ketë shishja, vëllimi i saj, ndërsa produktet e ofruara me katalog nuk ofrojnë përshtatshmëri në mungesë të specifikimeve.

Sa i përket pozicionit 18, Pretendimi i OE është i bazuar për faktin se OE në broshurë ka prezentuar letra absorbuese(e cila përdoret vetëm për tharje dhe pastrim) e që dallon nga një Guataperkë e cila përdoret për mbushjen e kanalit të rrënjës.

Katedra e Protetikës Stomatologjike

Sa i përket pozicionit 4, Pretendimi i OE është i bazuar për faktin se nga foto në broshurë nuk përmban asnjë të dhënë, edhe pse nga foto mund të duket si një silicon për masa bazuar në ngjyra dhe nuk mund të konsiderohet si ekuivalent sipas kërkesës së AK.

Katedra e Pedodoncisë dhe Stomatologjisë Preventive

Sa i përket pozicionit 14, pretendimi i Operatorit Ekonomik është i bazuar në faktin se OE fitues ka paraqitur dy lloje të shiringave (shiringë standarde dhe karposhiringë), ndërkohë që në materialin prezantues (broshurë) mungojnë imazhet e qarta dhe përshkrimet teknike që lidhen me gjilpërën dhe trupin e shiringës. Për më tepër, Autoriteti Kontraktor nuk ka specifikuar në dokumentacionin e kërkesës parametrat teknikë të gjilpërës, përfshirë madhësinë (numrin) dhe

karakteristikat përkatëse, çka e bën të vështirë verifikimin e përputhshmërisë së plotë të ofertës me kërkesat teknike.

Sa i përket pozicionit 20, Pretendimi i OE është i bazuar për faktin se OE ka ofertuar K-file prej Stainless Steele, ndërsa është kërkuar K-file Nikel Titanium.

Katedra e lëndëve Paramjekësore

Sa i përket pozicioneve 2,3,4, Pretendimi i OE nuk është i specifikuar.

Katedra e Infermierisë

Sa i përket pozicioneve 8,9,10, Pretendimi i OE nuk është i specifikuar.

Kimia Farmaceutike

Sa i përket pozicionit 4, Pretendimi i OE nuk është i specifikuar dhe nuk i përgjigjet pozicionit.

Sa i përket pozicionit 11, Pretendimi i OE është i bazuar për faktin se OE në broshurë ka ofruar substanca tjera.

Sa i përket pozicioneve 14,15,16,17, Pretendimi i OE është pjesërisht i bazuar pasi që pozicioni 14 mungojnë të dhënat ndërsa 15 dhe 16 janë të kërkuara si enë normale 50 dhe 100 ml pa cekur arsyen e përdorimit të tyre.

Katedra e lëndëve paramjekësore

Sa i përket pozicionit 2, Pretendimi i OE është pjesërisht i bazuar, për faktin se sa i përket pozicioneve paisja e kërkuar bën dezinfektimin e ajrit, ndërsa paisja e ofruar nuk e sterilizon ajrin dhe nuk i përgjigjet plotësisht përshkrimit teknik.

Paramjekësore

Sa i përket pozicioneve 1,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,17,18,24,25,26,27, Pretendimi i OE është pjesërisht i bazuar, pasi që fotot e paraqitura në broshurë në shumë raste nuk i kanë të cekura të dhënat dhe specifikat e produktit.

Katedra e analitika e barnave dhe legjislacioni farmaceutik

Sa i përket pozicionit 1 dhe 2, Pretendimi i OE është i bazuar, pasi që fotot në broshurë nuk japin asnjë informacion mbi produktin.

Katedra e Farmakologjisë me toksikologji dhe bromatologji

Sa i përket pozicioneve 1,4,6,7,8, Pretendimi i OE është i bazuar, pasi që fotot në broshurë nuk japin asnjë informacion mbi produktin.

Katedra e parodontologjisë dhe mjekesisë orale dhe ortodoncisë

Sa i përket pozicioneve 1,dhe 2, Pretendimi i OE është i bazuar, pasi që fotot në broshurë nuk japin asnjë informacion mbi produktin.

Infermiera, pjesa tjetër

Sa i përket pozicioneve 4,6,10,13,17,19,20 Pretendimi i OE është pjesërisht i bazuar, pasi që nga fotot në broshurë shihet që janë konform ofertës mirëpo nuk japin asnjë informacion mbi produktin.

Katedra e ortodoncisë

Sa i përket pozicionit 3, Pretendimi i OE është pjesërisht i bazuar, pasi që nga foto në broshurë shihet që janë konform ofertës mirëpo nuk japin asnjë informacion mbi produktin.

Rekomandim:

Edhe pse OE I rekomanduar për kontratë ka dorëzuar deklaratën përkatëse në të cilën zotohet se do të përmbahet kërkesave të Aneksit 1 të DT-së, oferta nuk mund të konsiderohet si e vlefshme për t'u vlerësuar, pasi është e pamundur të verifikohet përputhshmëria e produkteve (specifikimet teknike në broshurat ofruara). Dosja e tenderit nuk ka specifikuar çmimin për pozicion por vetëm si vlerë totale, tek përshkrimi i çmimit tek oferta, disa produkte të ofruara janë me çmime shumë herë më të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura në cilësinë e ekspertit teknik i rekomandoj panelit shqyrtues që ky aktivitet të anulohet në tërësi.

Duke u mbështetur në sqarimet e lartpërmendura nga eksperti teknik, eksperti shqyrtues mendon se dosja e tenderit ka paqartësi në përshkrimin e artikujve ashtu siç është paqartësi edhe te lista e çmimeve të sasia e kërkuar sipas pretendimit ankimor me numer 1.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Materiali shpenzues dhe pajisje speciale mjekësore me numër të prokurimit 242-25-9414-1-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrirat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë. Në këtë rast Paneli shpjegon se në këtë rastë raportin e ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues, dhe teknik mirpo ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, duke vendosur që të anulohet ky aktivitet në tërësi, dhe kërkon nga AK që në rastë të ri-tenderimit të kenë kujdes që iniciimin e procedurës ta bëjnë në harmoni me specifikacionet teknike të detyruara dhe me listën e çmimeve, sasisë së kërkuar, sikurse është përshkruar edhe në raportin e ekspertizës.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që

ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe argumenteve ka arritur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - UNIVERSITETI I PRISHTINËS**
- **OE - " Inovix " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: